



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 468/1 Prot

Shkodër më 21.07 2025

VENDIM

Nr. 14, Datë 16.07.2025

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË
BUXHETIT PËR PERIUDHËN 4/MUJORE JANAR- PRILL TË VITIT 2025, PËR
KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR**

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 16.07.2025, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit "Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën 4/mujore janar- prill të vitit 2025, për Këshillin e Qarkut Shkodër", bazuar në nenin 40, 41, 44, 77 shkronja dh, 78, pika 3 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 48 të Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr.22, datë 30.7.2018 "Per procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Ligjin 115/2024 "Per Buxhetin e Vitit 2025", VKQ Shkoder nr.26, datë 20.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027", VKQ Shkoder nr.6, datë 13.03.2025 "Mbi disa ndryshime ne VKQ nr.6, date 20.12.2024- Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027", Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me 17 Vota **Pro**, 0 Vota **Kunder** dhe 0 Vota **Abstenim**,

VENDOSI;

1. Miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të 4/mujorit të parë të vitit 2025 dhe tabelat e realizimit të buxhetit, pjesë përbërëse të këtij vendimi, për ;

- a) Raportin e shpenzimeve sipas programeve.
 - b) Raportin e shpenzimeve të programeve sipas artikujve.
 - c) Projektet e investimeve me financim të brëndshëm.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

